

PROJEKT PËR BINJAKËZIM I IPA-s
“MBËSHTETJE PËR PARANDALIMIN DHE LUFTIMIN
EFIKAS TË KORRUPSIONIT”

Projektin e financon Bashkimi Evropian, ndërsa e zbatojnë
Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit i vendit nikoqir dhe Shërbimi
Administrativ Federal i RF të Gjermanisë

Doracak
për mbrojtjen e sinjalizuesve

Shkup

shtator 2016

Ky botim është përgatitur me ndihmën e Bashkimit Evropian. Përgjegjësinë e vetme lidhur me përmbajtjen e këtij botimi e mban Projekti për Binjakëzim i IPA-s “Mbështetje për parandalimin dhe luftimin efikas të korrupsionit” dhe në asnjë mënyrë nuk mund të llogaritet si reflektim i qëndrimeve të Bashkimit Evropian.



Përmbajtja

1 PARAFJALË	3
2. ÇFARË ËSHTË	
2KORRUPSIONI?.....	3
ÇFARË ËSHTË SINJALIZIMI?	
3.....	4
4 LIGJE DHE AKTE NËNLIGJORE	5
4.1 LIGJI PËR MBROJTJEN E SINJALIZUESVE	5
4.1.1 ÇKA RREGULLOHET ME LIGJIN PËR MBROJTJEN E SINJALIZUESVE?	5
4.1.2 KUSH MUND TË JETË SINJALIZUES?	5
4.1.3 ÇFARË LLOJESH SINJALIZIMESH TË MBROJTURA KA?	6
4.1.4 MBROJTJA E IDENTITETIT DHE TË DHËNAVE PERSONALE TË SINJALIZUESVE.....	9
4.1.5 SIGURIMI I MBROJTJES SË SINJALIZUESVE.....	10
4.1.6 MBROJTJA GJYQËSORE DHE BARRA E PROVËS	12
4.1.7 SHFUQIZIMI I DISPOZITAVE NË KONTRATA DHE AKTE DHE KOMPENSIMI I DËMIT	13
4.1.8 KEQPËRDORIMI I SINJALIZIMEVE NGA SINJALIZUESIT.....	13
4.1.9 SINJALIZIMET E PRANUARA NGA SINJALIZUESIT	13
4.1.10 DISPOZITAT KUNDËRVAJTËSE	14
4.2 AKTET NËNLIGJORE NË FUNKSION TË ZBATIMIT TË LIGJIT PËR MBROJTJEN E SINJALIZUESVE ...	15
4.2.1 AKTET NËNLIGJORE IDENTIKE	15
4.2.1.1 Cilat janë përgjegjësitë e drejtuesve lidhur me emërimin e personave të autorizuar?	15
4.2.1.2 Cilat janë kushtet që duhet t'i sigurohen personit të autorizuar?.....	16
4.2.2 TRAJTIMI I SINJALIZIMEVE TË SINJALIZUESVE	17
4.2.3 Për rregulloren me udhëzimet për miratimin e akteve të brendshme të sinjalizimit të mbrojtur të brendshëm në subjekt juridik të sektorit privat	20

Parafjalë

I nderuar lexues,

Ky doracak është përgatitur në kuadër të Projektit për Binjakëzim të IPA-s 2010 “Mbështetje për parandalimin dhe luftimin efikas të korrupsionit”. Përmes këtij doracaku lexuesi do ta kuptojë domosdoshmërinë për mbrojtjen e sinjalizuesve dhe rolin e tyre në çdo sistem demokratik që parandalon dhe lufton korrupsionin.

Edhe pse ky doracak para së gjithash iu dedikohet të punësuarve në administratën shtetërore dhe publike, mendojmë se do të jetë i dobishëm edhe për opinionin e gjerë dhe qytetarët, të cilët në përditshmërinë e tyre kanë kontakt të drejtpërdrejtë me administratën.

Cili është qëllimi ynë?

Një administratë e pakorruptuar duhet të jetë patjetër objektiv i secilit shtet demokratik ku ka sundim të ligjit. Korrupsioni lëkund besimin në administratë legjitime, transparente dhe të përgjegjshme, si dhe kërcënon parimin e sundimit të ligjit. Nga dëmi që shkakton korrupsioni, pa përjashtim vuajnë qytetarët dhe interesi publik. Korrupsioni në masë të madhe ndikon negativisht mbi ekonominë, zhvillimin dhe prosperitetin e vendit. Përveç ryshfetit si një nga karakteristikat më të shprehura të korrupsionit, financat publike i dëmton edhe një nga fenomenet e tij më problematike – përdorimi i tyre i korruptuar, respektivisht keqpërdorimi i mjeteve publike, sepse këto vlera në të shumtën e rasteve janë disa herë më të larta sesa ryshfeti.

Për nga natyra që ka, kryerja ose pjesëmarrja në akte korruptive mbështetet në fshehtësi dhe diskrecion. Zakonisht, në interes të të dy palëve të kyçura – edhe në interes të dhënësit dhe pranuesit të ryshfetit – është që të mos dalin në sipërfaqe detalet e transaksioneve jolegale. E drejta penale parashihet përgjegjësi për të dy palët pjesëmarrëse në këtë lloj transaksionesh dhe ato janë të rrezikuara të jenë objekt akuzash konform dispozitave përkatëse ligjore. Në shumë raste provat për veprime të tilla joligjore dalin në sipërfaqe vetëm me ndihmën e sinjalizuesve të brendshëm ose të jashtëm.

Pikërisht për shkak të kësaj, në çdo shoqëri demokratike që synon të avancojë kulturën e një administrate të përgjegjshme, llogaridhënëse dhe transparente, këta persona meritojnë respektin më të madh dhe vendosjen e një sistemi formal për mbrojtjen e tyre.

1 Çfarë është korrupsioni?

Për termin “korrupsion” ekzistojnë definicione të shumta. Një nga definicionet e përdorura që përdorin më së shpeshti shumë shtete, është definicioni i organizatës *Transparency International* që thotë:

Korrupsioni është keqpërdorim i pushtetit të dhënë për përfitim personal.

Pa dallim se a bëhet fjalë për ryshfet aktiv apo pasiv në transaksionet afariste që bëhen jashtë apo brenda kufijve shtetërorë, korrupsioni shkakton jo vetëm dëm material, por edhe rrënon vlerat themelore në shoqëri.

Sipas Ligjit për parandalimin e korrupsionit, me korrupsion nënkuptohet “shfrytëzimi i funksionit, kompetencave, përgjegjësive dhe pozitave zyrtare për të përfituar çfarëdo lloj dobie personale ose për ndonjë person tjetër”.

2 Çfarë është sinjalizimi?

Sinjalizuesi ka rol të veçantë dhe të rëndësishëm, si në veprimet që ndërmerren për ta sprapsur korrupsionin, ashtu edhe në veprimet parandaluese që ndërmerren për ta luftuar atë.

Keqpërdorimet në institucione, pavarësisht a janë të sektorit publik apo atij privat, ndonjëherë zbulohen vetëm përmes zbardhjes së informacioneve të caktuara. Për të siguruar informacione të tilla përdoret termi “sinjalizim”. Sinjalizimi mund të jetë një pjesë e rëndësishme e zbulimit të keqpërdorimeve. Shpeshherë ky informacion ndërton bazën e hetimit fillestar administrativ, intern ose ekstern, që pastaj mund të rezultojë me hetim penal.

Sinjalizimi kërkon njohuri për informacionet e brendshme dhe guxim. Paraqitja e veprimeve joligjore nga ana e sinjalizuesve jep kontribut të çmueshëm drejt ndërtimit të një shoqërie më transparente. Kjo është e një rëndësie kyçe dhe për atë shkak, nëse nuk ekzistojnë struktura të mjaftueshme ose nëse nuk ka struktura që punojnë në drejtim të mbrojtjes së sinjalizuesve, atëherë sinjalizuesi rrezikohet të jetë objekt shpifjesh se është tradhtar.

Sinjalizuesit shpeshherë janë cak i sjelljeve armiqësore, presionit, diskriminimit, perceptohen si jobesnikë ndaj kolegëve ose strukturave udhëheqëse, prandaj ata drejtpërdrejt ose persona të afërm të tyre kanë presion nga të tjerët, apo jetojnë me frikën se do të pushohen nga puna.

Rrjedhimisht, që të eliminohen pasojat, të punësuarit në sektorin publik edhe ata në sektorin privat duhet të jenë të vetëdijshëm se për shkak të sinjalizimit të bërë, sinjalizuesve u takon mbrojtje ligjore nga çdo lloj shkelje e të drejtave, nga veprime të dëmshme, respektivisht mbrojtje nga rreziqe për veprime të dëmshme. Me miratimin e Ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve në muajin nëntor të vitit 2015 u bë një hap i madh në këtë drejtim. Më pastaj u miratuan edhe aktet nënligjore, të domosdoshme për zbatimin e ligjit.

3 Ligje dhe akte nënligjore

3.1 Ligji për mbrojtjen e sinjalizuesve

Në pjesën në vazhdim ligjet dhe dispozitat më të rëndësishme për mbrojtjen e sinjalizuesve do të shtjellohen në mënyrë sa më praktike, sepse ky dokument ka për qëllim të shërbejë si doracak dhe udhëzues për lexuesin, e jo si zëvendësim për nevojën të analizohen ligjet dhe aktet nënligjore për secilin rast veç e veç.

4.1.1 Çfarë rregullohet me Ligjin për mbrojtjen e sinjalizuesve?

Me Ligjin për mbrojtjen e sinjalizuesve rregullohet sinjalizimi i mbrojtur, të drejtat e sinjalizuesve, si dhe procedimi dhe përgjegjësitë e institucioneve, respektivisht subjekteve juridike, në lidhje me sinjalizimin e mbrojtur dhe sigurimin e mbrojtjes së sinjalizuesve.

Çfarë nënkuptohet me sinjalizimin e mbrojtur?

Sinjalizim i mbrojtur është ai sinjalizim që, në bazë të Ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve, lajmëron për një dyshim të arsyeshëm se është kryer, momentalisht kryhet ose supozohet që do të kryhet një veprim penal ose veprim tjetër joligjor apo i papranueshëm, që rrënon ose kërcënon interesin publik.

Interesi publik, në kuptimin më të gjerë, përfshin vlerat themelore të shoqërisë, e rrjedhimisht, në kontekst ligjor nënkupton mbrojtjen e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut dhe qytetarit (të njohura me të drejtën ndërkombëtare dhe të parapara me Kushtetutë), parandalimin e rreziqeve për shëndetin, mbrojtjen dhe sigurinë, mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe natyrës, mbrojtjen e pronës, tregut të lirë dhe afarizmit, sundimin e ligjit dhe parandalimin e krimit dhe korrupsionit.

4.1.2 Kush mund të jetë sinjalizues?

Ligji kryesisht përfshin personat të cilët mund të jenë në rolin e sinjalizuesve, e për atë arsye edhe rangohen në disa kategori:

- Personin në marrëdhënie pune të paafatizuar ose në marrëdhënie pune të afatizuar, në institucionin ose subjektin juridik për ku sinjalizon;
- Kandidatin për punësim, kandidatin për të qenë vullnetar ose praktikant në institucionin përkatës, respektivisht në subjektin juridik për ku sinjalizon;
- Personin që momentalisht është ose paraprakisht ka qenë vullnetar ose praktikant në institucionin përkatës, respektivisht në subjektin juridik për ku sinjalizon;
- Personin që është ose ka qenë i/e angazhuar në institucionin përkatës, respektivisht në subjektin juridik për ku sinjalizon;

Doracak

për mbrojtjen e sinjalizuesve

- Personin që është ose ka qenë në marrëdhënie pune ose raport tjetër bashkëpunimi me institucionin ose subjektin juridik për ku sinjalizon;
- Personin që shfrytëzon ose ka shfrytëzuar shërbime në institucionin përkatës, respektivisht në subjektin juridik në sektorin publik ose sektorin privat për ku sinjalizon.

ÇFARË ËSHTË ME RËNDËSI TË VEÇANTË PËR T'U THEKSUAR?

ÇFARË DUHET TË KENË PARASYSH KËTA PERSONA?

KËTO GJËRA NË VIJIM:

PERSONI QË BËN SINJALIZIM TË MBROJTUR DUHET TË KETË QËLLIMIN E MIRË DHE DYSHIMIN E ARSYESHËM NË VËRTETËSINË E INFORMACIONEVE TË PËRFSHIRA NË SINJALIZIM!

DHE SIDOMOS KËTË :

PERSONI QË SINJALIZON NUK E KA PËR DETYRË TA VËRTETOJË QËLLIMIN E MIRË DHE VËRTETËSINË E SINJALIZIMIT!

SINJALIZUESIT I SIGUROHET MBROJTJE SIÇ PARASHIHET ME LIGJ DHE I GARANTOHET ANONIMITET DERI NË ATË SHKALLË DHE DERI NË ATË MOMENT QË AI/AJO KËRKON ATË!

4.1.3 Çfarë llojesh sinjalizimesh të mbrojtura ka?

Ligji parasheh tri lloje të sinjalizimit të mbrojtur:

- sinjalizimi i mbrojtur i brendshëm;
- sinjalizimi i mbrojtur i jashtëm; dhe
- sinjalizimi i mbrojtur publik.

Për sinjalizimin e mbrojtur të brendshëm

Sinjalizimin e mbrojtur TË BRENDSHËM sinjalizuesi e bën në institucionin për ku ekziston dyshim ose informacion se është kryer, momentalisht kryhet ose do të kryhet një vepër penale ose vepër tjetër joligjore ose e papranueshme, me të cilën cenohet ose kërcënohet interesi publik.

Ku bëhet sinjalizimi?

Sinjalizimi bëhet tek personi i autorizuar për pranimin e sinjalizimeve nga sinjalizuesit.

Ai/ajo është personi i/e cila në institucion, respektivisht në subjektin juridik, është i/e autorizuar nga eprori i tij/saj të procedojë në bazë të sinjalizimeve nga sinjalizuesit.

Në rast se eprori, pra personi drejtues, nuk autorizon një person të caktuar për pranimin e sinjalizimeve nga sinjalizuesit konform ligjit, atëherë ai/ajo vetë merr përsipër rolin e personit të autorizuar.

Çfarë ndërmerr personi i autorizuar dhe si vepron?

- para së gjithash, personi i autorizuar ka për detyrë të procedojë lidhur me sinjalizimet dhe në këto raste të përkujdeset që kjo të bëhet sipas procedurave të parapara;
- gjatë procedimit ai/ajo mbron anonimitetin, respektivisht të dhënat personale të cilat mund ta zbulojnë identitetin e sinjalizuesit;
- nëse e di identitetin e sinjalizuesit, në afat prej 15 ditësh njofton sinjalizuesin për masat që ka ndërmarrë lidhur me sinjalizimin.

LEXUESI I KËTIJ DORACAKU DUHET TA KETË PARASYSH SE KA FORMË TË PARAPARË LIGJORE SI DUHET TË VEPROJNË PERSONAT E AUTORIZUAR – RREGULLORE PËR SINJALIZIMIN E MBROJTUR TË BRENDSHËM NË INSTITUCIONET E SEKTORIT PUBLIK, QË, MES TJERASH, PËRFSHIN EDHE ÇËSHTJET QË KANË TË BËJNË ME KRIJIMIN E KUSHTEVE OPTIMALE NGA ANA E INSTITUCIONIT QË KY PERSON TË MUND TË VEPROJË KONFORM PËRGJEGJËSIVE QË KA.

ME PËRMBAJTJEN E KËSAJ RREGULLOREJE LEXUESI DO TË NJIHET MË POSHTË NË KËTË TEKST.

Për sinjalizimin e mbrojtur të jashtëm

Sinjalizuesi mund të bëjë sinjalizim edhe jashtë institucionit përkatës, respektivisht subjektit juridik për ku bën sinjalizimin, dhe në këto raste sinjalizimi i tillë konsiderohet sinjalizim i mbrojtur I JASHTËM, por vetëm nën kritere të parapara me ligj.

Ku mund të bëhet sinjalizimi?

- Në Ministrinë e Punëve të Brendshme;
- Në prokurorinë publike përkatëse;
- Në Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit,
- Tek Avokati i Popullit; dhe
- Në institucione të tjera kompetente.

Cilat janë kriteret që duhet të plotësohen që ky sinjalizim të llogaritet sinjalizim i mbrojtur i jashtëm?

- Nëse sinjalizimi, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose indirekte, ka të bëjë me personin drejtues në institucionin ose subjektin juridik për ku sinjalizohet;
- Nëse sinjalizuesi për sinjalizimin që ka bërë në institucionin ose subjektin juridik përkatës, nuk merr përgjigje për masat që janë ndërmarrë brenda afatit të paraparë ligjor;
- Nëse nuk janë ndërmarrë masa fare;
- Nëse nuk është i/e kënaqur nga masat e ndërmarra; ose
- Nëse sinjalizimi që ka bërë në institucionin ose subjektin juridik përkatës do të shkaktojë pasoja të dëmshme për të ose për personat e afërm të tij/saj.

Si vepron organi ku bëhet sinjalizimi i mbrojtur i jashtëm?

Si për institucionet dhe subjektet juridike ku bëhet sinjalizimi i brendshëm, ashtu edhe për organet ku bëhet sinjalizimi i mbrojtur i brendshëm, ka akt-rregullore për sinjalizim të mbrojtur të jashtëm, ku parashihen rregullat dhe procedurat lidhur me atë se si duhet të veprojnë dhe çfarë masash duhet të ndërmerren në raste të këtilla.

Duke vepruar konform ligjit dhe procedurave të parapara, organi ku është bërë sinjalizimi i mbrojtur i jashtëm pikësepari duhet të vlerësojë a është kompetent për të vepruar lidhur me sinjalizimin dhe nëse konstatohet se nuk është kompetent, në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimit duhet ta përcjellë lëndën deri tek organi kompetent, dhe për këtë duhet ta informojë sinjalizuesin.

Organet shtetërore të lartpërmendura po ashtu kanë për detyrë të veprojnë në kuadër të kompetencave të tyre për të mbrojtur identitetin e sinjalizuesit, të dhënat personale dhe ta informojnë domosdo sinjalizuesin për masat që kanë ndërmarrë, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të sinjalizimit. Këto organe kanë për detyrë që sinjalizuesin ta informojnë për rezultatin pas përfundimit të shqyrtimit të lëndës.

Për sinjalizimin e mbrojtur publik

Sinjalizimin e mbrojtur PUBLIK sinjalizuesi e bën duke dhënë në dispozicion informacione që janë publike në lidhje me një vepër penale që është kryer, momentalisht kryhet ose ndoshta do të kryhet, me të cilën kërcënohet ose rrezikohet jeta e sinjalizuesit dhe e ndonjë të afërmi të tij/saj, shëndeti i njerëzve, siguria, mjedisi jetësor, dëme të përmasave më të mëdha, pra nëse ekziston rrezik i drejtpërdrejtë për shkatërrim provash.

Edhe gjatë hartimit të kësaj procedure motivet e ligjdhënësit janë mjaft të qarta, duke pasur parasysh bazën për këtë lloj sinjalizimi, ndërsa sinjalizuesi sidomos duhet ta ketë parasysh se do të jetë i mbrojtur konform ligjit vetëm nëse:

- paraprakisht ka bërë sinjalizim të mbrojtur të brendshëm, përkatësisht sinjalizim të mbrojtur të jashtëm dhe sidomos nëse sinjalizimin e bën konform kriterëve të përcaktuara (më lartë në tekst).

Shpërndarja e informacioneve në sferën publike obligon sinjalizuesin ta respektojë supozimin e pafajësisë, ta respektojë të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe të ketë kujdes të mos kërcënojë zhvillimin e procedurave gjyqësore.

Sinjalizuesi duhet të jetë i vetëdijshëm se shkelja e këtyre dispozitave do të rezultojë me humbjen e së drejtës për mbrojtje konform Ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve.

4.1.4 Mbrojtja e identitetit dhe të dhënave personale të sinjalizuesve

Lexuesi i këtij doracaku më lart në këtë tekst u informua për procedurat strikte të parapara lidhur me përgjegjësitë e personave të autorizuar për pranimin e sinjalizimeve nga sinjalizuesit. Në to, mes tjerash, janë paraparë edhe aspektet e mbrojtjes së identitetit dhe të dhënave personale të sinjalizuesit.

Me Ligjin për mbrojtjen e sinjalizuesve, zbulimi ose mundësimi i zbulimit të identitetit të sinjalizuesit është i ndaluar, përveç në rastet kur kjo kërkohet me vendim gjyqësor. Besimi i sinjalizuesve në zbatimin e këtyre normave dhe procedurave në parim inkurajojnë veprimet e tij/saj.

Personi i autorizuar për pranimin e sinjalizimeve nga sinjalizuesit është i detyrohet t'i mbrojë të dhënat personale të sinjalizuesit, sidomos të atyre që kërkojnë të mbetet anonimë. Kjo nuk vlen për sinjalizuesit që janë pajtuar të zbulojnë identitetin e tyre.

Doracak për mbrojtjen e sinjalizuesve

Në raste të caktuara, nëse gjatë zhvillimit të procedurës është i domosdoshëm zbulimi i identitetit të sinjalizuesit, personi i autorizuar është i detyruar ta informojë sinjalizuesin për këtë dhe kjo duhet të bëhet para zbulimit të identitetit. Ai/ajo duhet të njoftohet edhe për masat e parapara për mbrojtjen e pjesëmarrësve në procedurat penale.

4.1.5 Sigurimi i mbrojtjes së sinjalizuesve

Në vazhdim të këtij doracaku do të prezentohet thelbi i sistemit për mbrojtjen e sinjalizuesve dhe si mundësohet ky mekanizëm.

Nga emërtimi i ligjit për mbrojtje të sinjalizuesve, kushdo qoftë do të kishte vërejtur se thelbi i tij është pikërisht për atë qëllim – të sigurohet mbrojtja e personave-sinjalizues nga pasoja të mundshme për shkak të sinjalizimit që kanë bërë.

Prandaj janë shumë të qarta dispozitat me të cilat parashihet që sinjalizuesit dhe një të afërmi të tij/saj t'u sigurohet mbrojtje nga çdo lloj shkeljeje e të drejtave ose nga çfarëdo lloj veprimi i dëmshëm, apo nga rreziku që vjen nga ndërmarrja e veprimeve të dëmshme për shkak të sinjalizimit të mbrojtur të brendshëm, të jashtëm apo publik.

Cili është fushëveprimi i mbrojtjes dhe kush e siguron atë?

Përgjegjësinë për sigurimin e mbrojtjes së sinjalizuesit e ka institucioni ose subjekti juridik ku është bërë sinjalizimi dhe kjo zakonisht bëhet duke ndërmarrë veprime për të parandaluar shkeljen e të drejtave:

- për marrëdhënie pune ose çfarëdo të drejte tjetër, dhe
- maturi dhe përmbajtje nga veprime me të cilat cenohet ose kërcënohet cilado e drejtë e sinjalizuesit për shkak të sinjalizimit të bërë.

Ky fushëveprim i gjerë i mbrojtjes edhe një herë vërteton qëllimin e ligjdhënësit për ta fituar besimin e sinjalizuesit dhe për ta evituar “kurthin” e kategorizimit, që mund të jetë çdoherë i kufizuar, respektivisht mund të mos t'i përfshijë të gjitha situatat e mundshme të shkeljes së të drejtave të sinjalizuesit. Njëkohësisht kjo nënkupton se me asnjë ligj tjetër nuk mund të parashihen masa të cilat do t'i kishin rrezikuar të drejtat e sinjalizuesit për shkak të sinjalizimit të bërë.

Çfarë ndodh nëse institucioni përkatës apo subjekti juridik nuk siguron mbrojtje?

Ligji e parasheh dhe e rregullon edhe këtë situatë. Në rast se sinjalizuesit nuk i sigurohet mbrojtje nga ana e institucionit, respektivisht nga subjekti juridik ku është bërë sinjalizimi, ai/ajo mund t'ia paraqesë këtë menjëherë:

- Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit;
- Avokatit të Popullit;
- Këshillit Inspektues;
- Ministrisë së Punëve të Brendshme; dhe
- Prokurorisë Publike.

Konform kompetencave të veta, këto organe janë të detyruara të veprojnë pa shtyerje të afatit, menjëherë pas parashtrësës së dorëzuar se nuk janë ndërmarrë veprimet e duhura.

Cilët janë hapat e ardhshëm?

Organet e sipërpërmednura kanë për detyrë që nga institucioni përkatës apo subjekti juridik ku është bërë sinjalizimi, pa asnjë mundësi shtyerjeje, të kërkojnë informacione për ekzistimin e çfarëdo lloj shkeljeje të të drejtave të sinjalizuesit dhe anëtarëve të familjes së tij/saj për shkak të sinjalizimit të bërë.

Në bazë të kësaj kërkesë, institucioni përkatës apo subjekti juridik është i detyruar të veprojë, respektivisht duhet menjëherë të informojë në afat prej 8 (tetë) ditësh.

Çfarë ndodh nëse konstatohet se sinjalizuesit i janë shkelur të drejtat?

Në raste të këtilla këto organe kërkojnë që institucioni përkatës apo subjekti juridik të ndërmarrë masa urgjente për mbrojtjen e sinjalizuesit duke ndërprerë veprimet apo duke minimizuar lëshimet e bëra me të cilat cenohen të drejtat e sinjalizuesit. Për këtë e njoftojnë menjëherë edhe sinjalizuesin.

Ligjdhënësi ka paraparë dhe ka definuar edhe mundësinë që shkelja e të drejtave të sinjalizuesit të vazhdojë edhe krahas masave të përmendura më sipër.

Nëse kjo ndodh, organet të cilat tashmë i cekëm, janë të detyruara që pa asnjë shtyerje, e më së voni në afat prej tetë ditësh, të ndërmarrin masa më konkrete, si më poshtë:

- të ngrenë iniciativë për procedurë penale;
- të ngrenë iniciativë për shkarkim, risistematizim dhe/ose zëvendësim para organeve kompetente; ose
- të zbatojnë masa të tjera për të konstatuar përgjegjësinë e personave të zgjedhur ose të emëruar, zyrtarëve ose personave përgjegjës në ndërmarrjet publike ose subjektet e tjera juridike që disponojnë kapital shtetëror.

Doracak për mbrojtjen e sinjalizuesve

Lexuesi i këtij doracaku duhet ta dijë se Ligji për mbrojtjen e sinjalizuesve parasheh edhe situata që kanë të bëjnë me një nivel “më të lartë” mbrojtjeje.

Konkretisht, nëse sinjalizuesi ka ngritur padi penale kundër shtetit, njerëzimit dhe së drejtës ndërkombëtare nga sfera e krimit të organizuar dhe për të cilin më Kodin Penal parashihet dënim prej së paku katër vjet burgim, e për provë domosdoshmërisht nevojitet dëshmia e sinjalizuesit që nuk pajtohet të paraqitet si dëshmitar/e – atëherë institucionet janë të obliguara t'i zbatojnë dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e dëshmitarëve.

4.1.6 Mbrojtja gjyqësore dhe barra e provës

Nga përmbajtja e prezantuar në këtë pjesë të doracakut, lexuesi pati mundësinë të mësojë mbi masat e parapara në ligj që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave të sinjalizuesit në nivel institucioni, respektivisht në nivel subjekti juridik ku është bërë sinjalizimi.

Por nëse masat që kanë ndërmarrë organet nuk kanë efekt, pra nëse janë shkelur të drejtat e sinjalizuesit?

Në atë rast, konform ligjit, sinjalizuesi ka të drejtën e mbrojtjes gjyqësore!

Mbrojtjen e këtyre sinjalizuesit mund ta realizojë me padi para gjykatës kompetente, duke kërkuar në këtë mënyrë:

- të konstatohet se është ndërmarrë veprim i dëmshëm ose është shkelur një e drejtë për shkak të sinjalizimit;
- të ndalohen veprimet e dëmshme ose shkelja e së drejtës, si dhe përsëritja e veprimit të dëmshëm ose përsëritja e shkeljes së të drejtës;
- të shfuqizohet akti ligjor me të cilin është dëmtuar ose është cenuar një e drejtë;
- të mënjanojnë pasojat nga veprimi i dëmshëm ose shkelja e së drejtës;
- të bëhet kompensim për dëmin material dhe jomaterial.

Kjo procedurë para gjykatës kompetente kërkon shqyrtim urgjent!

Me rëndësi është që sinjalizuesi ta dijë se në rast se kërkon mbrojtje gjyqësore, barra e provës i takon institucionit përkatës, respektivisht subjektit juridik që ka shkelur të drejtat e sinjalizuesit, e jo atij/asaj.

4.1.7 Shfuqizimi i dispozitave në kontrata dhe akte dhe kompensimi i dëmit

Konsiderojmë se edhe dy instrumente të tjera të parapara me këtë ligj mbështesin fuqishëm mbrojtjen e sinjalizuesve: instrumenti i parë është shfuqizimi i kontratave dhe aktvendimeve për marrëdhënie pune me të cilat ndalohet paraqitja apo sinjalizimi.

Beteja e sinjalizuesit për të mbrojtur të drejtat e tij/saj në gjitha këto procedura do të ishte e kotë nëse nuk gëzon të drejtën e kompensimit për dëmin e pësuar. Ligji parasheh edhe këtë aspekt dhe udhëzon sinjalizuesin ta realizojë atë të drejtë para gjykatës kompetente.

4.1.8 Keqpërdorimi i sinjalizimeve nga sinjalizuesit

Mbrojtja e garantuar e sinjalizuesve për sinjalizimin që kanë bërë llogaritet si një përfitim jashtëzakonisht pozitiv në çdo shoqëri demokratike që synon sundimin e ligjit. Por gjithmonë ka rrezik që instrumente të caktuara të keqpërdoren. Kjo ndodh edhe me sinjalizimin.

Për këtë arsye, ligji definon në mënyrë koncize këtë veprim, duke potencuar se keqpërdorimi i sinjalizimit nga sinjalizuesi është përcjellje e vetëdijshme e informatave të pavërteta për persona fizikë ose subjekte juridike, me qëllim të dëmtimit të atij personi apo subjekti.

Keqpërdorim i sinjalizimit konsiderohet edhe kur sinjalizuesi, brenda mundësive ekzistuese, nuk ka pasur kujdesin e mjaftueshëm dhe ndërgjegjshmërinë për të kontrolluar saktësinë dhe vërtetësinë e informacioneve.

Sigurisht që ky lloj keqpërdorimi sanksionohet dhe nëse kjo gjë vërtetohet, sinjalizuesi humb të drejtën (që i takon me ligj) për t'u mbrojtur dhe, për më tepër, keqpërdorimi i sinjalizimit që ka rezultuar me pasoja paraqet bazë për ngritjen e procedurës për verifikimin e përgjegjësinë së tij/saj.

4.1.9 Sinjalizimet e pranuar nga sinjalizuesit

Zbatimi i Ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve dhe sidomos efektet nga zbatimi i tij janë të interesit publik, prandaj ligjdhënësi ka paraparë që institucionet përkatëse për këto sinjalizime të raportojnë si më poshtë:

Doracak për mbrojtjen e sinjalizuesve

- institucionet dhe subjektet juridike ku bëhet sinjalizim i mbrojtur i brendshëm dhe i jashtëm – i dorëzojnë Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit raport çdo gjashtë muaj; dhe
- Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit dhe Ministria e Drejtësisë, secili organ veç e veç, i dorëzojnë Kuvendit raporte një herë në vit.

4.1.10 Dispozitat kundërvajtëse

Nga përmbajtja e paraqitur deri më tani në këtë doracak u informuat se ligji përmban një numër të madh të përgjegjësive, si për personin e autorizuar për pranimin e sinjalizimeve nga sinjalizuesit, ashtu edhe për institucionet kompetente dhe subjektet juridike ku bëhet sinjalizimi, por edhe për organet e tjera dhe zyrtarët që udhëheqin me to.

Vlerat e rritura të gjobave të përcaktuara për shkeljen e dispozitave të ligjit edhe një herë vërtetojnë qëllimin determinues për të realizuar objektivat në luftën e vazhdueshme kundër korrupsionit.

Lexuesi duhet ta ketë parasysh edhe një moment tjetër po aq të rëndësishëm – ligji nuk lejon që nën pretekstin e sinjalizimit të mbrojtur, të shfrytëzohen materiale nga përgjimi i paligjshëm i komunikimeve në periudhën prej vitit 2008 deri në vitin 2015.

4.2 AKTET NËNLIGJORE NË FUNKSION TË ZBATIMIT TË LIGJIT PËR MBROJTJEN E SINJALIZUESVE

Në pjesën hyrëse të këtij doracakut përmendëm se ligji u plotësua edhe me akte nënligjore, të cilat kanë për qëllim të trajtojnë segmente të caktuara të procedurave të parapara.

Ato akte nënligjore janë siç vijon:

- Rregullore për sinjalizim të brendshëm të mbrojtur në institucionet e sektorit publik;
- Rregullore për sinjalizim të jashtëm të mbrojtur; dhe
- Rregullore me udhëzime për miratimin e akteve të brendshme për sinjalizim të brendshëm të mbrojtur në subjektin juridik në sektorin privat.

Këto akte duhet të sigurojnë vazhdimësi në funksionimin e institucioneve dhe subjekteve juridike, që nga ana tjetër inkurajon sinjalizuesit në qëllimin e tyre për të sinjalizuar.

Duke u nisur nga kjo, në këtë pjesë të doracakut do t'u kushtojmë vëmendje disa pjesëve të këtyre akteve nënligjore që lexuesi duhet t'i ketë parasysh, sidomos nëse bëhet fjalë për person të autorizuar për pranimin e sinjalizimeve nga sinjalizuesit.

4.2.1 Aktet nënligjore identike

Karakteristike për rregulloret që trajtojnë sinjalizimet e brendshme dhe të jashtme të mbrojtura është se ato trajtojnë në mënyrë identike më shumë çështje.

Në fakt të dyja rregulloret, ajo që trajton sinjalizimin e mbrojtur të brendshëm dhe rregullorja që trajton sinjalizimin e mbrojtur të jashtëm, trajtojnë hollësisht përgjegjësitë ligjore të personit udhëheqës të institucionit, respektivisht të subjektit juridik ku është bërë sinjalizimi.

4.2.1.1 Cilat janë përgjegjësitë e drejtuesve lidhur me emërimin e personave të autorizuar?

Përgjegjësi e parë është emërimi i detyrueshëm i personit të autorizuar.

Në përmbushjen e këtij obligimi, respektivisht gjatë emërimit të personit të autorizuar, drejtuesi duhet të marrë parasysh kriteret që ai person duhet t'i plotësojë, e ato janë:

Doracak për mbrojtje të sinjalizuesve

- Të jetë në pozitë udhëheqëse;
- Të ketë mbaruar arsimin e lartë në fushën e shkencave juridike, të sigurisë ose shkencave ekonomike;
- Të posedojë çertifikatë sigurie me shkallën e duhur të konfidencialitetit për qasje në informacione të klasifikuara;
- Të ketë përvojë në shqyrtimin e ankesave apo parashtresave, në punën me klientë, mbikëqyrje, veprime hetimore ose inspektuese, përvojë auditimi apo kontrolli të brendshëm ose përvojë tjetër pune në kryerjen e detyrave në konfidencialitet, praninë dhe dërgim të të dhënave tek institucionet e tjera dhe referimin e palëve.

Nëse drejtuesi nuk plotëson detyrimin për emërimin e personit të autorizuar, detyrën e merr përsipër vetë ai/ajo. Përmes këtij modaliteti, ligji garanton se në të gjitha institucionet publike është siguruar trajtimi i sinjalizimeve nga sinjalizuesit.

Lexuesi i këtij doracak, por edhe opinioni më i gjerë, duhet të jenë të informuar se të dhënat për personin e autorizuar, si emri dhe mbiemri, vendi i punës dhe numri i telefonit për kontakt, publikohen në faqen e internetit të institucionit, por i dorëzohen edhe Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit.

Tashmë e cekëm më sipër se të dyja rregulloret trajtojnë më shumë çështje në mënyrë identike. Ashtu është edhe me kushtet e parapara lidhur me sigurimin e hapësirës dhe pajisjeve për personin e autorizuar, si në institucionet dhe subjektet juridike ku bëhet sinjalizim i mbrojtur i brendshëm, ashtu edhe në organet ku bëhet sinjalizimi i mbrojtur i jashtëm.

4.2.1.2 Cilat janë kushtet që duhet t'i sigurohen personit të autorizuar?

- hapësirë për punë, të përshtatshme për pranimin e palëve;
- kompjuter special që do të jetë i siguruar dhe funksional vetëm me profilin e personit të autorizuar, me lidhje interneti dhe postë elektronike e fjalëkalim të veçantë të personit të autorizuar;
- vulë e posaçme pranimi;
- libër i posaçëm i protokollit ditor;
- postë elektronike të veçantë;
- lidhje e posaçme telefonike;
- raft dokumentesh për ruajtje të sigurt të sinjalizimeve të pranuar, procesverbaleve, dokumenteve të pranuar dhe dokumenteve të përgatitura, si dhe materialeve tjera që kanë të bëjnë me sinjalizimin e mbrojtur, libër i posaçëm i protokollit ditor dhe vulë pranuese; dhe
- pajisje të tjera për zbatimin e masave teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të dhënave tjera që kanë të bëjnë me sinjalizues dhe sinjalizime, gjithmonë duke pasur parasysh rregulloret për mbrojtjen e të dhënave personale dhe rregulloret për mbrojtjen e informacioneve të klasifikuara.

4.2.2 Trajtimi i sinjalizimeve të sinjalizuesve

Personi i autorizuar organizon aspektin administrativ, duke bërë pranimin e sinjalizimeve me shkrim, respektivisht zbaton procedurat e evidentimit dhe ruajtjes, por në rast se sinjalizimi është bërë gojarisht, personi i autorizuar duhet të përpilojë një procesverbal me këtë përmbajtje:

a) të dhënat për sinjalizuesin:

- emrin dhe mbiemrin;
- kategorinë e personit që mund të ketë statusin e sinjalizuesit konform ligjit;
- kërkesën e sinjalizuesit që të mbetet i fshehtë dhe shkallën e konfidencialitetit që kërkon.

b) të dhënat për personin a subjektin ndaj kujt sinjalizuesi paraqet sinjalizim;

c) përshkrimin e veprimit të ndëshkueshëm ose të një veprimi tjetër të paligjshëm dhe të papranueshëm, që cenon ose rrezikon interesin publik;

d) propozimet e sinjalizuesit për mënyrën dhe formën e komunikimit mes personit të autorizuar dhe sinjalizuesit;

e) shtojcat;

f) datën dhe vendin e pranimit të sinjalizimit.

Sinjalizuesi e vërteton përmbajtjen e procesverbalit duke e nënshkruar personalisht.

Gjithmonë ekziston mundësia që sinjalizimi të dërgohet edhe në formë elektronike, prandaj për personin e autorizuar parashihen edhe procedurat për trajtimin edhe të këtij lloji sinjalizimi.

Çfarë ndërmerr personi i autorizuar pas pranimit të sinjalizimit?

Është me rëndësi të theksohet se personi i autorizuar ka për detyrë ta evidentojë sinjalizimin ditën e njëjtë kur është pranuar dhe ta shqyrtojë, respektivisht ta studiojë përmbajtjen e tij.

Nga shqyrtimi i tërthortë i përmbajtjes, personi i autorizuar mund të konstatojë se lënda e pranuar nuk është sinjalizim nga sinjalizues dhe menjëherë bën shënimin e duhur, mban një kopje të lëndës, ndërsa origjinalin me dokumentet e bashkëngjitura, me letër përcjellëse e dorëzon në institucionin kompetent.

Kuptohet, për këtë menjëherë informon sinjalizuesin, nëse identiteti i tij/saj dihet.

Tashmë thamë se personi i autorizuar menjëherë shqyrton dhe analizon përmbajtjen e sinjalizimit.

Çfarë do të thotë kjo?

Kjo do të thotë se bëhet vlerësimi i logjikës dhe arsyeshmërisë së përmbajtjes, konstatohet se a bëhet fjalë për sinjalizim nga sinjalizues dhe a përmban mjaftueshëm elemente që të dorëzohet për procedim të mëtutjeshëm. Për këtë vlerësim, personi i autorizuar mund të kërkojë ndihmën e sinjalizuesit (nëse e di identitetin e tij/saj) ose nga persona të tjerë.

Ky vlerësim është bazë që personi i autorizuar për procedimin e mëtejshëm të miratojë konkluzione dhe të konstatojë nëse institucioni përkatës është kompetent për të trajtuar lëndën apo jo.

Personi i autorizuar e ka për detyrë ta njoftojë eprorin e tij/saj për gjetjet dhe konkluzionet e miratuara, pa vonesa të panevojshme, me përjashtim kur sinjalizimi ka të bëjë me vetë eprorin. Në atë rast sinjalizimin e përcjell tek institucioni kompetent.

Nëse personi i autorizuar pas vlerësimit të bërë konstaton se për shqyrtimin e sinjalizimit është kompetent një institucion tjetër, më së voni në afat prej tetë ditësh ia dorëzon lëndën institucionit përkatës. Por, është jashtëzakonisht me rëndësi që personi i autorizuar ta ketë parasysh që – nëse sinjalizimi ka të bëjë me vepër penale kundër shtetit, njerëzimit ose së drejtës ndërkombëtare nga sfera e krimit të organizuar, dhe për të cilën Kodi Penal parasheh dënim prej së paku katër vjetësh burg, e që mund të vërtetohet me vështirësi ose që nuk mund të vërtetohet pa dëshminë e sinjalizuesit, që nga frika, kërcënimet e mundshme për hakmarrje ose rrezikimi i jetës, shëndetit, lirisë, integritetit fizik apo pasurisë që posedon, nuk pajtohet të japë deklaratë si dëshmitar – atëherë personi i autorizuar, duke siguruar deklaratë me shkrim nga sinjalizuesi, pa vonesë i drejtohet Ministrisë së Punëve të Brendshme ose Prokurorit Publik për procedim të mëtejshëm, konform Ligjit për mbrojtjen e dëshmitarëve.

Pas vlerësimit të bërë, kur personi i autorizuar do të konstatojë se ka elemente të mjaftueshme për procedim të mëtejshëm, lëndën ia dorëzon nëpunësit të autorizuar brenda institucionit kompetent për trajtimin e çështjes përkatëse, varësisht nga fusha që trajton sinjalizimi.

Gjatë zhvillimit të gjithë kësaj procedure, personi i autorizuar duhet të ketë kujdes të jashtëzakonshëm në mbrojtjen e të dhënave personale të sinjalizuesit konform ligjit dhe gjatë gjithë kohës duhet ta informojë atë për veprimet që ka ndërmarrë.

Cilat përgjegjësitë tjera i ka personi i autorizuar në zbatimin e ligjit?

E një rëndësie të madhe për ngritjen e vetëdijes së përgjithshme të qytetarëve për rolin e sinjalizuesve në luftën kundër korrupsionit është që të monitorohen efektet nga zbatimi i Ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve.

Pikërisht për këtë arsye edhe ligji ka paraparë detyrimin për të raportuar për çështjet e këtij lëmi, ndërsa rregulloret përcaktojnë formën me të cilën personat e autorizuar detyrohen që të japin të dhëna për sinjalizime të pranuar nga sinjalizues.

Këto raporte përmbajnë të dhëna të shumta, si për shembull:

Të dhëna statistikore të përgjithshme:

- a) Numrin e përgjithshëm të sinjalizimeve të pranuar;
- b) Numrin e sinjalizimeve të pranuar sipas parametrave më poshtë:
 - Formën dhe mënyrën e dërgimit të sinjalizimit (gojarisht – të dokumentuar në procesverbal, me shkrim përmes postës, me shkrim përmes postës elektronike);
 - Veprimin e ndëshkueshëm ose të papranueshëm;
 - Kategorinë e personave me status sinjalizuesi;
 - Pozitën e punës të personave që janë objekt sinjalizimi;
 - Sinjalizuesit konfidencialë;
 - Sinjalizuesit anonimë;
 - Sinjalizuesit të cilët nuk janë anonimë dhe nuk kërkojnë të jenë konfidencialë;
- c) Numrin e përgjithshëm të sinjalizuesve;
- d) Numrin e sinjalizuesve anonimë;
- e) Numrin e sinjalizuesve konfidencialë;
- f) Numrin e sinjalizimeve që i janë dorëzuar institucionit kompetent për procedim të mëtejshëm;
- g) Numrin e sinjalizimeve që ka trajtuar institucioni në suaza të kompetencave të veta.

Të dhëna për lëndë të hapura pas sinjalizimeve të pranuar:

- a) Numrin e përgjithshëm të sinjalizimeve të pranuar;
- b) Numrin e sinjalizimeve të pranuar sipas parametrave më poshtë:

Doracak për mbrojtjen e sinjalizuesve

- Formën dhe mënyrën e dorëzimit të sinjalizimeve (gojarisht – të dokumentuar në procesverbal, me shkrim përmes postës, me shkrim përmes postës elektronike);
- Veprimin e ndëshkueshëm ose të papranueshëm;
- Kategorinë e personave me status sinjalizuesi;
- Pozitën e punës të personave që janë objekt sinjalizimi;
- Sinjalizuesit konfidencialë;
- Sinjalizuesit anonimë;
- Sinjalizuesit që nuk janë anonimë dhe nuk kërkojnë të jenë konfidencialë;

c) Numrin e përgjithshëm të sinjalizuesve që kanë dorëzuar sinjalizime për lëndë të hapura;

d) Numrin e sinjalizuesve anonimë që kanë dorëzuar sinjalizime për lëndë të hapura;

e) Numrin e sinjalizuesve konfidencialë që kanë dorëzuar sinjalizime për lëndë të hapura;

f) Numrin e lëndëve të hapura pas sinjalizimeve të pranuar;

g) Masat që janë ndërmarrë lidhur me sinjalizimet e pranuar;

h) Statusin e lëndëve të hapura pas sinjalizimeve të pranuar dhe rezultatet nga shqyrtimi i lëndëve.

4.2.3 Për rregulloren me udhëzimet për miratimin e akteve të brendshme të sinjalizimit të mbrojtur të brendshëm në subjekt juridik të sektorit privat

Dokumenti nuk do të ishte i plotë dhe nuk do ta kishte përfshirë me përpikmëri qëllimin e Ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve nëse lexuesi nuk merr parasysh që ky doracak nuk bën dallim dhe vlen për sistemin në tërësi, e rrjedhimisht çdo sinjalizues është mbrojtur, pavarësisht se a është bërë sinjalizimi në sektorin publik apo atë privat.

Sinjalizimi i mbrojtur i brendshëm është një nga elementet e sistemit të integritetit që paraqet modelin e qeverisjes së mirë apo të një sistemi të harmonizuar, dhe është pjesë e politikës për luftën kundër korrupsionit ose pjesë e programit të subjektit juridik në sektorin privat. Një sistem për sinjalizim të mbrojtur të brendshëm, i vendosur mbi baza të shëndosha dhe të suksesshme, forcon integritetin e subjektit juridik, zvogëlon rreziqet për korrupsion, mbron reputacionin e subjektit juridik, kontribuon për ndërtimin e mirëbesimit në komunitet, e me këtë ndikon pozitivisht edhe në konkurrencën e tregut.

Përmendëm më sipër se ligji është i qartë lidhur me mbrojtjen e sinjalizuesve, pavarësisht asaj se ku ndodh sinjalizimi, e rrjedhimisht janë paraparë detyrime edhe për subjektet juridike të sektorit privat.

Doracak

për mbrojtjen e sinjalizuesve

Këto subjekte janë të detyruara ta definojnë sinjalizimin e mbrojtur të brendshëm me aktet e tyre të brendshme.

Për zbatimin e barabartë të Ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve, për sferën e sektorit privat ligdhënësi ka paraparë miratimin e rregullores me udhëzimet për miratimin e akteve të brendshme për sinjalizimin e mbrojtur të brendshëm në subjektin juridik në sektorin privat.

Me këtë dokument personave juridikë në sektorin privat u përcaktohen udhëzimet për miratimin e akteve të brendshme lidhur me sinjalizimin e mbrojtur të brendshëm, duke iu referuar edhe akteve nënligjore që kanë të bëjnë me sektorin publik.

Më poshtë janë potencuar segmentet që duhet të merren parasysh:

- Të ketë qasje të plotë te personi apo vendi i caktuar për sinjalizim të mbrojtur të brendshëm dhe të gjithë të punësuarit në subjektin juridik ta kenë në dispozicion aktin e brendshëm për sinjalizimin e mbrojtur të brendshëm;
- Të shfuqizohen dispozitat në aktet dhe marrëveshjet që përcaktojnë të drejtat për marrëdhënie pune dhe angazhime të tjera, e me të cilat ndalohet sinjalizimi për dyshim ose informacione për kryerjen e një vepre penale ose veprimi tjetër joligjor ose të papranueshëm, që cenon ose kërcënon interesin publik, sigurinë dhe mbrojtjen, apo kur sinjalizimi i tillë definohet si shkelje e dispozitave të konfidencialitetit, lojalitetit dhe profesionalizmit;
- Të mbrohen sinjalizuesit dhe të afërmit e tij/saj nga çdo lloj shkeljeje e të drejtave ose veprimi dëmtues apo rreziku nga veprime dëmtuese si rezultat i sinjalizimit të bërë;
- Të ndalohet zbulimi apo mundësia për të zbuluar identitetin e sinjalizuesit, përveç në raste kur kjo kërkohet me vendim gjyqësor;
- Të mbrohen të dhënat personale të sinjalizuesit;
- Të mbrohen të dhënat dhe sinjalizimet e pranuar, procesverbalet ose dokumentet e pranuar ose të përgatitura, apo materialet tjera që kanë të bëjnë me sinjalizimin e mbrojtur;
- Sinjalizuesi ta ketë të drejtën të jetë i informuar, pa vonesa ose brenda një periudhe të caktuar konform ligjit, si për masat që janë ndërmarrë lidhur me sinjalizimin, ashtu edhe për masat që janë ndërmarrë për mbrojtjen e tij/saj;
- Rekomandime për sinjalizim të mbrojtur të jashtëm, respektivisht sinjalizim të mbrojtur publik;

Bashkëpunimi mes subjekteve juridike në sektorin privat dhe kyçja e tyre në shoqatat afariste dhe profesionale mund të kontribuojë në krijimin, vendosjen dhe mbikëqyrjen e sinjalizimit të mbrojtur të brendshëm në sektorin privat.